



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 136, datë 28.09.2017

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLOREN NR. 25, DATË 23.02.2011
“PËR RAPORTIMIN NË AMF TË VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË
ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË PENSIONIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Mbikëqyrjes të Tregut të Fondeve të Pensioneve, të Fondeve të Investimeve dhe të Titujve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave në Rregulloren nr. 25, datë 23.02.2011 “Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

Në Rregulloren nr. 25, datë 23.02.2011 “Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 4, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Shoqëria administruese depoziton në AMF raportin vjetor të kontrollit të brendshëm në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë dhe fondit të pensionit që ajo administron.”

2. Në nenin 7:

a) Pika 1, pas fjalës “të paaudituar” shtohet shprehja “si dhe për nën periudhat raportuese gjatë vitit ushtrimor” dhe në fund të fjalisë, shprehja “deri më 31 mars të vitit pasardhës”, zëvendësohet me shprehjen “deri më datë 15 të muajit pas përfundimit të periudhës raportuese”.

b) pika 3 ndryshon si vijon:

“3. Shoqëria administruese depoziton në AMF raportin vjetor të kontrollit të brendshëm brenda muajit janar të çdo viti pasardhës.”

3. Në nenin 8:

a) pika 1, pas shprehjes “në formë elektronike” shtohet shprehja “në format excel dhe pdf pranë departamentit përkatës të Autoritetit”.

b) pika 2, shprehja, “paragrafi 1”, zëvendësohet me shprehjen “paragrafi 2”.

4. Në shtojcat bashkëlidhur rregullores, shtojca 2, pika 1 “Pasqyrat financiare të fondit të pensionit”, ndryshon si më poshtë vijon:

Shtojca 2 - Pasqyrat financiare të fondit të pensionit

1. Pasqyra e asetëve të fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Zërat e aktivitetit	Lek	Lek
	Periudha e mëparshme	Periudha aktuale
1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		
2. Investime (2.1+2.2+2.3)		
2.1 Letra borxhi të blera në emetimin e parë (2.1.a+2.1.b+2.1.c)		

2.1.a. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
2.1.b. Investime financiare të vlefshme për shitje		
2.1.c. Investime financiare të mbajtura deri në maturim		
2.2 Letra borxhi të blera në treg sekondar (2.2.a+2.2.b+2.2.c)		
2.2.a. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
2.2.b. Investime financiare të vlefshme për shitje		
2.2.c. Investime financiare të mbajtura deri në maturim		
2.3 Depozita		
3. Llogari të arkëtueshme		
3a. Të arkëtueshme nga shitja e letrave me vlerë		
3b. Të arkëtueshme nga shoqëria administruese		
3c. Të arkëtueshme nga depozitari		
3d. Parapagime		
3e. Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë		
3f. Të tjera llogari të arkëtueshme		
A (1+2+3) TOTALI I AKTIVEVE		
4. Detyrime nga investimi në letrat me vlerë		
5. Detyrime nga investimi në depozita		
6. Detyrime ndaj shoqërisë administruese		
7. Detyrime ndaj depozitarit		
8. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë		
9. Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë		
10. Detyrime të tjera		
B (4+5+6+7+8+9+10) TOTALI I DETYRIMEVE		
C (A-B) AKTIVET NETO TË FONDIT TË PENSIONIT		
D NUMRI I KUOTAVE TË FONDIT TË PENSIONIT		
E (C/D) AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT		

5. Në shtojcat bashkëlidhur rregullores, shtojca 2, pika 5.2 “Pasqyra e strukturës së investimeve, Obligacionet”, ndryshon si më poshtë vijon:

5.2.Pasqyra e strukturës së investimeve, Obligacionet

Emri i fondit të pensionit: _____

Kodi i fondit të pensionit: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Lloji	Vlera nominale (Lek)	Shpenzimet e blerjes (Lek)	Vlera në datën e raportimit (Lek)	Pjesa ndaj kapitalit të emetuesit, %	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
-------	----------------------	----------------------------	-----------------------------------	--------------------------------------	---

Obligacione të Qeverisë (brenda vendit)					
Të mbajtura deri në maturim (HTM)					
2 vjeçare					
3 vjeçare					
5 vjeçare					
7 vjeçare					
10 vjeçare					
Me qëllim tregtimin (HFT)					
2 vjeçare					
3 vjeçare					
5 vjeçare					
7 vjeçare					
10 vjeçare					
Obligacione të shoqërive (brenda vendit)					
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE VENDAS					
Obligacione të Qeverive (jashtë vendit)					
Obligacione të shoqërive (jashtë vendit)					
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE TË HUAJ					